



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 2124/3 prot.

Tiranë, më 29.09.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2124/1, DATË 26.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA ZNJ. ZHANETA HARIZAJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e znj. Zhaneta Harizaj, me nr. 1169 prot, datë 15.06.2020 dhe nr. 1369 prot, datë 29.06.2020 ndaj veprimtarisë së magjistratëve V. S., T. H., V. Ç., D. A., dhe I. D., me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Durrës dhe me vendimin nr. 2124/1 prot, datë 26.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “për përfundimin pa një vendim përfundimtar të ankesave të paraqitura nga znj. Zhaneta Harizaj”, bazuar në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqënëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Durrës, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja nr 1, Rruga “Anastas Durrsaku”, Pallati “Dekon”, kati 2, Durrës;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

